



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:068768

Datë: 27.01.2024

Numri i dokumentit: 05252676

P.nr.959/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit M.R nga Obiliqi, i akuzuar për veprat penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 dhe 1 të KPRK-së dhe veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 3 lidhur me par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.681/2020 të datës 14.04.2021, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 27.12.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi, i akuzuari M.R dhe mbrojtësit sipas detyrës zyrtare av. Beshir Zani, me datë 03.01.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.01.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.R, i biri i R dhe nëna E., e gjinisë F., i lindur me, në H. KK O..., me vendbanim në rrugën “A. J.” LL.... k-.. nr...., Komuna e O., me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 09.01.2020, rreth orës 03:22h, në O..., në rrugën nacionale P. – M., tek rreth rrotullimi në fshatin M. i pandehuri M.R, nën ndikimin e alkoolit, derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës “P..407”, ngjyrë e zezë, me tabela të regjistrimit 01-...-..., nga pakujdesia, duke menduar lehtë se nuk do të rrezikoi komunikacionin, nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit, duke rrezikuare jetën e njerëzve dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 53 dhe nenin 233 të Ligjit mbi bazat e sigurisë së trafikut, /Nr.05/L-88/, i cili duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit ndaj kushteve dhe gjendjes në komunikacion, hyn në rreth rrotullim me shpejtësi, humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe me pjesën e përparme të majtë e godet shenjen e trafikut, pastaj kalon konstruktin fizik të rrethit në të djathtë dhe pastaj me pjesën e përparme e godet shtyllën elektrike prej betonit ngjitur për murit të maketet , me ç ‘rast lëndime të rëndë trupore, pëson pasagjeri i automjetit “P... 407”, H.G. dhe vetë i pandehuri dhe shkaktohet aksident trafikut me dëme materiale,-

- *Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par. 8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-ës.*

II. Të njëjtën ditë dhe në të njëjtin vend, si në dispozitivin e parë të aktakuzës, i pandehuri M.R, derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës “P.. 407”, ngjyrë e zezë, me tabela të regjistrimit 01-...-..., i cili duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve dhe rrethanave të krijuara në rrugë, nën ndikimin e alkoolit, e humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe me pjesën e përparmë e godet shtyllën elektrike prej betonit ngjitur për murit të marketit, me ç ‘rast lëndime të rëndë trupore, pëson pasagjeri i automjetit “P... 407”, H. G. dhe shkaktohet aksident komunikacioni,-

- *Me këtë e ka kryer veprën penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-ës.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 23, 38, 39, 40, 46, 48, 69, 70, 71, 72, 76, 370 dhe 371 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i:

P ë r c a k t o n

- I. Për veprën penale nga **pika 1** e dispozitivit dënimit me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj,
- II. Për veprën penale nga **pika 2** e dispozitivit dënimit me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj,

Ne kuptim te nenit 76 te KPRK-së, gjykata te pandehurin e **gjykon** me

DËNIM ME KUSHT

- I. Duke i përcaktuar dënimit unik me burgim ne kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbaj nëse në afat prej 2 (dy) viteve, nuk kryen vepër te re penale.
- II. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të kriminit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Pala e dëmtuar H. G. udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizon në procedurë të rregullt civilo-juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.681/2020 të datës 14.04.2021, ndaj të akuzuarit M.R për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprat penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par 8 lidhur me par 6 dhe 1 të KPRK-së dhe veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur neni 371 par 3 lidhur me par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 27.12.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi dhe të pandehurit M.R ku i njëjti u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit M.R qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370, paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe par.1 dhe veprës Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-ës.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën nga pakujdesia, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer, si dhe faktin se i njëjti nuk ka qenë i dënuar me parë. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit, ndërsa si rrethanë rënduese nuk janë konstatuar nga Gjykata.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 43 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjesisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 te KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 te KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.959/21 datë 27.01.2024**

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.